

## Kushtet e Përdorimit të Platformes Open Banking

Mirë se vini në Platformen Open Banking të Bankes Amerikane të Investimeve SHA (“ABI Bank”). Ju lutemi te lexoni me kujdes të gjitha kushtet e përdorimit përpara se të vijoni me aplikimin për regjistrim dhe të aksesoni Platformen për përdorimin e saj.

### 1. Hyrje

Këto Kushte dhe Terma (“Kushtet”) rregullojnë aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të Open Banking të ABI Bank nga Ofruesit e Shërbimit të Pagesave në dokumentet referuar si TPP. Duke hyrë ose përdorur API të ABI Bank dhe duke përzgjedhur opsionin “pranoj” tek forma e aplikimit, ju pranoni të respektoni këto Kushte, si dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Kushtet, bazohen në:

- Ligji nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”;
- Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standartet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit”, miratuar me Vendimin Nr. 29, datë 01.06.2022 të Këshillit Mbiqyres;
- Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
- Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian, datë 27 Prill 2016.

### 2. Përkufizime

- Banka: i referohet ABI Bank, që ofron shërbime Open Banking përmes API.
- TPP - Third Party Provider ose Ofruesi I Shërbimit të Pagesave - OSHP: Çdo subjekt i autorizuar, që ka akses dhe përdor API të ABI Bank.
- Klienti: Individu që mban një llogari në ABI Bank dhe jep pëlqimin për shërbimet e ofruara nga TPP (ose OSHP).
- Open Banking: Një kornizë e sigurt që lejon TPP-të (ose OSHP-të) e autorizuar të kenë akses në të dhënat financiare të klientëve ose të iniciojnë pagesa përmes API, me pëlqimin e qartë dhe të plotë të klientit.

### 3. Qëllimi i Platformës Open Banking

Platforma Open Banking ofron mundësinë që një TPP (ose OSHP) t’i ofrojë akses klientëve të Bankës në të dhënat e tyre financiare si dhe mundësinë që të kryejnë shërbime pagesash në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

### 4. Përdoruesit e Autorizuar

TPP (ose OSHP) janë të gjitha subjektet të cilave u është dhënë akses në Platformë nga ana e Bankës, në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë së funksionimit të Platformës, dhe që do të ushtrojnë aktivitetin për të cilin janë licencuar dhe certifikuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

TPP-të (ose OSHP-të) duhet të marrin pëlqim të qartë dhe të plotë nga Klienti përpara se të kenë akses në të dhënat e tyre në Bankë ose të iniciojnë pagesa.

### 5. Kushtet e Përdorimit të Platformës

- 5.1 TPP (ose OSHP) dakordësohet se do të përdorë Platformën në përputhje me kërkesat ligjore dhe vetëm për qëllimin për të cilin është vënë në përdorim nga Banka, sipas kushteve të përdorimit. Çdo përdorim tjetër i ndryshëm, i paautorizuar dhe i padakortësuar, në shkelje të ligjit apo të kushteve të përdorimit, do të konsiderohet i paligjshëm dhe do të përbëjë shkak për ndërprerjen e shërbimit nga Banka.
- 5.2 Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të kushteve të përdorimit të Platformës në çdo kohë, me njoftim paraprak apo me efekt të menjëhershëm, me qëllim përmirësimin e shërbimit, për arsye sigurie, të rritjes së funksionalitetit, për shkak të ndryshimeve ligjore apo nënligjore, ose për shkak të politikave tregtare dhe

gjykimit të Bankës. Njoftimi për ndryshime dhe kushtet e ndryshuara do të publikohen nga Banka dhe do të përcaktohet edhe afati i hyrjes në fuqi të këtyre kushteve.

- 5.3 Është përgjegjësia e Përdoruesit të Autorizuar të krijojë mbrojtjen e duhur nga viruset dhe kërcënimet e tjera kibernetike përkundrejt pajisjeve/programeve në pronësi të tij si hardware, software, apo të dhëna të tij si pasojë e përdorimit të Platformës Open Banking.
- 5.4 Të gjitha të drejtat e autorit dhe të pronësisë intelektuale mbi Platformën Open Banking, sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe dokumentat që Përdoruesi i Autorizuar përfiton nëpërmjet përdorimit të saj, janë në pronësi të Bankës, duke përfshirë edhe cdo ndryshim, përmirësim, apo zhvillim që mund të ndodhë në të ardhmen. Përdoruesi i Autorizuar është i detyruar t'i përdorë ato vetëm me qëllim përmbushjen e funksionit të vetë dhe deri në masën e duhur.

## **6. Kufizimi i Përgjegjësise**

Përdoruesi i Autorizuar gjatë përdorimit të Platformës Open Banking garanton që disponon pajisje dhe mundësi teknike të përshtatshme dhe ka krijuar ambjente të sigurta nga rreziku kibernetik për sistemet e saj Hardware, Software si dhe protokollet e shkëmbimit të të dhënave. Banka do të kufizojë përgjegjësitë e saj përkundrejt Përdoruesve të Autorizuar apo të tretëve, duke qenë e përjashtuar ndaj çdo pretendimi për dëme që mund të vijnë si rezultat i humbjeve, fitimit të munguar, uljes së pasurisë apo dëmeve morale apo te imazhit, vetëm në rastet kur vërtetohet se këto dëme kanë ardhur si përgjegjësi direkte e veprimeve të saj dhe janë të lidhura drejtpërdrejtë me përdorimin e Platformës Open Banking.

## **7. Pezullimi i perkohshem i shërbimeve**

Përdoruesi i Autorizuar dakordësohet se Banka për shkaqe sigurie për efekt të përmirësimit të cilësisë së shërbimit në Platformë, apo për shkaqe që i gjykon të arsyeshme, mund të pezullojë përkohësisht ofrimin e shërbimit, për periudha kohore të arsyeshme. Në këto raste Banka do të bëjë përpjekjet maksimale që të njoftojë Përdoruesit e Autorizuar nëpërmjet njoftimeve për pezullimin e shërbimeve dhe afatet për rivendosjen në funksion të tyre.

## **8. Forca Madhore.**

Banka nuk do të konsiderohet përgjegjëse për mospërmbushjen ose vonesën e përmbushjes së detyrimeve kontraktore në rast se kjo vonesë shkaktohet si pasojë e një force madhore: akt lufte, terrorizem, sabotim, fatkeqesi natyrore, pandemi, epidemi, ndërprerje e energjisë elektrike, interneti ose telekomunikacioni që nuk është shkaktuar nga pala e detyruar por për shkak të forcave apo ngjarjeve madhore, kufizime qeveritare, ndryshime ligjore apo rregullatore të cilat prekin aktivitetin e palëve, apo ngjarje të tjera jashtë kontrollit të Bankës.

## **9. Privatësia dhe Siguria e të Dhënave**

- 9.1 Banka Amerikane e Investimeve SHA respekton privatësinë dhe sigurinë e të dhënave personale të klientëve. Të gjitha të dhënat personale që do të shkëmbehen mes palëve, do të trajtohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar në fuqi dhe do të përdoren vetëm për qëllime të përcaktuara.
- 9.2 Banka Amerikane e Investimeve SHA përdor teknologji të avancuara për të mbrojtur të dhënat personale të klientëve nga qasje të paautorizuara, humbje, shkatërrim, ose modifikim. Këto masa përfshijnë kriptimin e të dhënave, autentikimin me dy faktorë, kontrolle të qasjes, auditime të rregullta dhe procedura të tjera teknike dhe organizative të sigurta.
- 9.3 Të gjithë TPP (ose OSHP) që kanë akses në të dhënat e klientëve përmes Platformës Open Banking, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave. TPP (ose OSHP) janë të detyruar të zbatojnë të njëjtat standarde të sigurisë dhe privatësisë që Banka Amerikane e Investimeve SHA aplikon ndaj të dhënave të klientëve.
- 9.4 Përdoruesit e Autorizuar do të sigurojnë që çdo e dhënë e klientit e marrë përmes API të Platformës Open Banking do të ruhet vetëm për aq kohë sa është e nevojshme në përputhje me rregulloret në fuqi

## **10. Standarte të Privatësisë dhe Konfidencialitetit**

10.1 Të dyja palët detyrohen të ruajnë e të mos përhapin informacionin që përfitohet si rrjedhojë e zbatimit të kësaj kontrate. Në veçanti, por pa u kufizuar në to, informacion konfidencial është “informacioni për transaksionet e kryera, për balancat e llogarisë, emrat e mbajtësve të llogarive bankare, si dhe çdo informacion që njihet në mënyrë rastësore prej Përdoruesit të Autorizuar”.

Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të përmendur më sipër ndaj palëve të treta, përveç personave përgjegjës të të dyja palëve, që janë autorizuar të shkëmbejnë informacion dypalësh për plotësimin e detyrimeve të kësaj kontrate.

10.2 Informacioni, i cili do të konsiderohet si e dhenë personale, do të trajtohet dhe përpunohet në përputhje të plotë me parashikimet ligjore në fuqi.

10.3 Palët janë të detyruara që, dhe pasi të jetë zgjidhur kontrata mes tyre, të trajtojnë përgjithmonë konfidencial informacionin e përshkruar në pikën 10.1, pa asnjë kufizim kohor.

10.4 Palët bien dakort dhe konsiderojnë si rreptësisht konfidenciale cdo informacion, apo të gjitha informacionet të komunikuar mes tyre në lidhje me aktivitetin ekonomik, produktet, shërbimet, dhe të mos bëjnë publike informacione të tilla, tërësisht apo pjesërisht, për cdo person të tretë si dhe të mos përdorin këtë informacion për ndonjë qëllim tjetër të ndryshëm nga sa përcaktohet në këtë marrëveshje.

10.5 Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen do t'i japë të drejtën Bankës të përfundojë menjëherë këtë marrëdhënie duke i bërë një njoftim me shkrim Përdoruesit të Autorizuar, pa cënuar kjo të drejtën e Bankës që të kërkojë prej tij zhdëmtim të dëmit të shkaktuar.